

Prof.Asoc.Dr. Rudina Rama është e punësuar me kohë të plotë pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës.

Ka një përvojë pune shumë vjeçare si pedagoge dhe studiuese në Universitetin e Tiranës. Pas diplomimit në punë sociale në vitin 1996, ka kryer studimet pasuniversitare në punë sociale dhe administrim publik, më pas ato doktorale në të njëjtën fushë studimi dhe që nga viti 2015 mban gradën shkencore profesore e asociuar.

Fushat e mësimdhënies dhe ekspertizës kërkimore përfshijnë dimensionin social në kujdesin shëndetësor, administrimin e politikave dhe shërbimeve sociale; mirëqënien e fëmijëve dhe të rinjve dhe aplikimin e metodave kërkimore në fushën e drejtësisë penale.

Gjatë përvojës profesionale është përfshirë në një sërë projektesh kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e shkencave sociale të mbështetura nga qeveria e Republikës së Çekisë, Irlandës, nga projekte të financuara nga Komisioni Evropian nëpërmjet programve Erasmus +, Evropa për qytetarët etj.

Nga vitit 2016 – 2020 ka qenë përgjegjëse e departamentit të punës dhe politikës sociale.

Gjithashtu, ka marrë pjesë në një sërë konferencash kombëtare dhe ndërkombëtare të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit, ka botuar një sërë artikujsh shkencorë në revista prestigjioze dhe të indeksuara dhe është bashkëautore e disa librave të botuara nga shtëpi botuese prestigjioze ndërkombëtare.

Aktualisht është senatore e Universitetit të Tiranës dhe zv dekan e Fakultetit të Shkencave Sociale.